

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2023*

18.05.2023

Ora 13:00

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Shqyrtimi i kërkesës nr. 31 të Komisionerit Shtetëror të  
Zgjedhjeve me objekt “Vendosje të sanksioneve administrative”.

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaç, Znj. I. Osmanaj.
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. K. Bele:** Përshëndetje, deklarojmë të çelur seancën e sotme, në fakt riçelim seancën për shqyrtimin në themel. Seancë e cila është pezullur ditën e premte, për efekt të mungesës së kurumit në vendimarrje, në reflektim të vendimit të Kolegjit si dhe duke reflektuar ndarjen e votave në shqyrtimin paraprak. Relatojmë prezencën e plotë të KAS-it me 5 anëtarë dhe anëtari Elvis Çefa i cili është njohur paraprakisht me fazën e procedimit dhe me relatimin e çështjes në këtë fazë, zoti Çefa ka ndonjë pyetje, apo diçka tjetër që do të donit të ndanit me ne?

**Z. E. Çefa:** Jo, asnjë pyetje faleminderit, jam plotësisht i qartë për çështjen.

**Z. K. Bele:** Atëherë duke qënë se palët i kanë dhënë konkluzionet, si përfaqësuesit e KQZ-së, konstatojmë se nuk kemi palë të tjera në seancë. Në këtë moment

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 18.05.2023*

procedural, KAS tërhiqet për vendim, për t'u shprehur lidhur me themelin e çështjes. Vendimi i cili do të jepet për pak minuta.

**Rifillon seanca**

**Ora 13:09**

**Z. K. Bele:** Riçelim seancën, KAS në përfundim të shqyrtimit me shumic votash është bazuar në nenin 21 pika 1 shkronja “dh” të ligjit numër 10019, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, vendosi:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës numër 31, datë 12.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Rakip Suli kryetar i Bashkisë Kamëz dhe ndaj zotit Blerim Shera kryetar i Bashkisë Vorë, sipas nenit 172 pika 1 të Kodit Zgjedhor, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.
- U shpall sot në datë 18 Maj 2023, me kaq seanca deklarohej e mbyllur.

**Vendimi nr. 115**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2023*

**18.05.2023  
Ora 13:26**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për kthimin për plotësim të kërkesës ankimore nr. 61, subjekti ankues Partia Lëvizja e Legalitetit”.**

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Ledio BRAHO, Z. Koli BELE.

**Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj.

**Të tjerë:** KRIIK.

**Z. L. Braho:** Atëhere, përshëndetje çelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes kërkesës ankimore numër 61, subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit ka depozituar sot në KQZ, kërkesën ankimore numër 61, e protokolluar datë 18.05.2023. Në lëndën e kërkesës ankimore citohet ankimim në lidhje me numërimin e votave nga grupet e numërimit pranë KZAZ-së, dhe në përmbajtjen e kërkesës lexojmë që pretendimet kanë të bëjnë me KZAZ që janë pjesë e Bashkisë Tiranë, KZAZ-ja 37, KZAZ-ja 29 dhe KZAZ-ja 41. Ndërkohë nga elementet e kërkesës vërehet që nuk është referuar vendimi që ankimohet, nuk ka as bazë ligjore dhe përshkrimi i shkeljes është i paqartë. Po ashtu nuk janë treguar as frovat me të cilat pala ankimuese e bazon këtë ankimim, përveç se pretendon se ka një mospërputhje të votave të dala në ekran me ato të pasqyruara në procesverbal. I pranishëm është dhe përfaqësuesi i KQZ-së zoti Ylli Merkaj. Zoti Merkaj, ju çfarë qëndrimi keni në lidhje me këtë kërkesë ankimore përse i përket elementëve të formës dhe të përmbajtjes.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Po, nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se nuk i plotëson kriteëret e parashikuara në nenin 126 pasi nuk ka bërë përshkrimin e shkurtër të shkeljes, nuk ka treguar faktet dhe argumentet ku bazohet ankimi, si dhe provat në të cilat është mbështetur ankimi. Në këto kushte ne i kërkojmë KAS-it ta kthejë kërkesën për plotësim duke i lënë afat 24 orë.

**Z. L. Braho:** Faleminderit, atëhere KAS i konsultuar në vend, në zbatim të nenit 129, pika 3, shkronja c, e Kodit Zgjedhor, vendos t'i kthejë subjektit zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit kërkesën për plotësimin e elementëve dhe të formës të përcaktuar në nenin 126, të Kodit Zgjedhor, më konkretisht vendimin që ankimohet, bazën ligjore, përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar, si dhe tregimin e provave në të cilat kërkon të jap gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit dhe burimin e tyre. Vendimi u shpall sot në datë 18.05.2023, ora 13:29. Seancën e deklarojmë të mbyllur.

Atëhere e riçelim dhe një herë seancën! Seanca për verifikimin e elementëve të formës duke respektuar dhe afatin 24 orë, do të lihet nesër në datë 19 maj 2023, ora 13:30. Njoftohet dhe pala.

**Vendimi nr. 116**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2023*

**18.05.2023  
Ora 13:30**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 62, subjekti ankues Partia Unitetit Kombëtar”.**

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Ledio BRAHO, Z. Koli BELE.

**Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj.

**Të tjerë:** KRIIK.

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve! Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të elementëve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës ankimore me numër 62, të datë 17 maj 2023, paraqitur nga Partia Unitetit Kombëtar. Relator i kësaj çështjeje sipas shortit të hedhur në KQZ ditën e sotme, jam caktuar unë Elvis Çefa, verifikojmë shkurtimisht prezencën, është prezent trupa e plotë e KAS-it në përbërje të plotë, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Deklarata në këtë moment, paraprake, nuk ka nga anëtarët e Kas-it për ndonjë konflikt të mundshëm interes. Personi i interesuar nuk është prezent, pra ankimuesi, më falni, nuk është prezent, kështu që ne shkurtimisht në vlerësimin e kërkesës ankimore paraprakisht vërehet që ka një përshkrim të shkurtër dhe jo të detajuar të rrethanave të faktit, pra arrijmë të konstatojmë faktin që ankimuesi kundërshton tabelat e rezultateve përsa i përket KZAZ-së numër 12 dhe 13, por nuk ka specifikuar vendimin përkatës të KZAZ-së të cilën kundërshton, dhe po ashtu panvarësisht se ka bërë një spjegim të fakteve sipas tij, ai nuk i ka bashkëlidhur kësaj kërkesë ankimore asnjë provë. Në këtë kontekst, në një vlerësim a prima facia të kërkesës

**Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2023*

ankimore, konstatohet që ai është me të meta, gjithësesi shkurtimisht zoti Merkaj, ju çfarë mendimi keni si përfaqësues i KQZ-së?

**Z. Y. Merkaj:** Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se nuk plotëson elementët e nenit 126, të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it kthimin e kërkesës për plotësim duke lënë një afat 24 orë. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Atëhere KAS i konsultuar në vend vendosi kthimin, bazuar në nenin 129, pika 3/c, vendosi kthimin për plotësim të subjektit ankimues të kërkesës ankimore, duke i kërkuar që të citojë qartësisht vendimet e KZAZ-së të cilat ankimon me anë të kësaj kërkesë ankimore, si dhe të bashkëlidhi të gjitha provat që ai i konsideron të arsyeshme, që mund të ndihmojnë KAS-in në shqyrtimin në themel të kësaj kërkesë dhe të bëj një përshkrim më të detajuar të fakteve dhe rrethanave konkrete, që sipas tij vërtetojnë që vendimet që ai kundërshton janë marrë në kundërshtim me ligjin. Seanca paraprake, pas plotësimit të kërkesës do të bëhet, pra, në kalim të 24 orëve, ditën e nesërme në datë 19 maj 2023, në orën 13:40. Me kaq këtë seancë e deklarojmë të mbyllur. Faleminderit!

**Vendimi nr. 117**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

